



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Nr. 1091 regj.themeltar
Datë regjistrimi 09.09.2024

Nr. 2491/7 vendimi
Datë vendimi 08.10.2024

VENDIM

“Mbi depozitimimin e akteve në regjistrin e organizatave jofitimprurëse”

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë nga:

Gjyqtare: Anila Guri (Kristani)

sot më datë 08.10.2024, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi materialet e çështjes civile që i përket:

KËRKUES: Shoqtata “Federata Shqiptare e Notit”, përfaqësuar nga z.Agim Çiraku.

OBJEKTI: Depozitimi i akteve të Asamblesë së Përgjithshme zgjedhore datë 26.08.2024 të Federatës Shqiptare të Notit dhe i procesverbalit të mbledhjes.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.8788 datë 07.05.2001, ligji nr.8789 datë 07.05.2001, ligji nr.79/2017, ligji nr.80/2021.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën dhe aktet bashkëlidhur saj:

KONSTATOI SE:

Ka rezultuar se me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me nr.24981 datë 04.03.2009 është vendosur regjistrimi në regjistrin përkatës të organizatave jofitimprurëse pranë kësaj gjykate të shoqatës “Federata Shqiptare e Notit”.

Kërkuesi me kërkesën drejtuar gjykatës ka kërkuar depozitimimin pranë Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të vendimit të datës 26.08.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të antarëve të Federatës Shqiptare të Notit.

Sipas përmbajtjes së vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të antarëve të datës 26.08.2024, rezulton se ne mbledhjen e mbajtur ku kanë marrë pjesë tetë anëtarë, me votat unanime të tyre është vendosur:

Zgjedhja e z.Agim Çiraku në detyrën e presidentit të Federatës Shqiptare të Notit.

Zgjedhjen e Komitetit Drejtues të Federatës Shqiptare të Notit prej katër antarëve, të cilët janë:

z.Albert Bozhanaj

z.Illir Ngresi

znj.Keida Ushtelenca

znj.Valbona Cako

Gjykata vlerëson se procedura dhe vendimmarrja sa më sipër e Asamblesë së Përgjithshme të antarëve është zhvilluar në përputhje me përcaktimet ligjore të dispozitave statutores dhe kërkesave të ligjit Nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe ligjit Nr. 8789 datë 07.05.2001 “ Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, ligjin nr.79/2017 “Për sportin” dhe në këto rrethana gjykata vlerëson se kërkesa është e drejtë dhe si i tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të ligjit nr.8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, dhe ligjit nr.8789 datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”,

V E N D O S I

Pranimin e kërkesës.

Depozitimim në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të antarëve të Federatës Shqiptare të Notit të datës 26.08.2024, me të cilin është vendosur:

Zgjedhja e z.Agim Çiraku në detyrën e presidentit të Federatës Shqiptare të Notit.

Zgjedhjen e Komitetit Drejtues të Federatës Shqiptare të Notit prej katër antarëve, të cilët janë:

z.Albert Bozhanaj

z.Illir Ngresi

znj.Keida Ushtelenca

znj.Valbona Cako

Urdhërimin e sekretarit të regjistrimit të organizatave jofitimprurëse të regjistrojë vendimin sa sipër dhe të pasqyrojë ndryshimet në skedën perkatëse.

Tiranë, më datë 08.10.2024.

GJYQTARE
Anila GURI (KRISTANI)

